



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.764/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi, Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit Hazbije Shala nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Rahovecit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.764/2021 i datës 03.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Rahovecit, Hazbije Shala nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Rahovecit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet 1604A/01D, 1609A/01R, 1609A/03R, 1610A/01R, 1610A/02R, 1610A/03R, 1612A/01R, 1612A/02R, 1622A /01R, 1622A /03D, 1624A/01R, 1624A /03R, 1627A /01R, 1637A/01D, 1640A /01D.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimin për Kandidat për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, në Komunën e Rahovecit, në Vendvotimet 1604A/ 01D, 1609A/ 01R, 1609A/03R, 1610A /01R, 1610A/ 02R, 1610A /03R, 1612A /01R, 1612A/ 02R, 1622A /01R, 1622A /03D, 1624A/ 01R, 1624A /03R, 1627A /01R, 1637A/ 01D, 1640A /01D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.764/2021, i ushtruar nga Hazbije Shala , Kandidat për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se në disa vendvotime nuk figurojnë votat , pasi që në disa vendvotime janë edhe votat e familjarëve. Vendvotimet në të cilat pretendoj se nuk figurojnë votat janë 1604A/ 01D, 1609A/ 01R, 1609A/03R, 1610A /01R, 1610A/ 02R, 1610A /03R, 1612A /01R, 1612A/ 02R, 1622A /01R, 1622A /03D, 1624A/ 01R, 1624A /03R, 1627A /01R, 1637A/ 01D, 1640A /01D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit te provave te bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Hazbije Shala, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet e lartcekura, PZAP, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimet e lartcekur është i bazuar.

Paneli vlerëson se apeli është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidati, ku shihet qarte se nga deklaratat e votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës deklarohet se në qendrat ku gjenden vendvotimet e precizuara nga ana e ankueses, kanë votuar për kandidaten Hazbije Shala. Paneli pasi vlerësoi votat të cilat i ka ankuesja dhe deklaratat e bashkangjitura në apel rezulton se ka mospërputhje të rezultatit në raport me pretendimet e ankuese dhe deklaratimet nga familjaret e ankueses në deklaratat e bashkangjitura, prandaj vendosi që vendvotimet e cekura si në dispozitiv të dërgohen në rinumërim.

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këto vendvotime e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 764/2021 më datën 06.11.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.